



MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE E MBROJTJES SOCIALE
OPERATORI I SHËRBIMIVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
QENDRA SPITALORE RAJONALE BERAT
NJESIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Berat, më _____ / _____ /2025.

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE, TERMAT E REFERENCES
DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i kontratës/marrveshjes kuadër: “Blerje barnash te deleguara për nevoja Spitalore ndarë në 11 (njembedhjetë) lote-
Marrveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për secilin lot)- ku të gjitha kushtet
janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT

Produkte Farmaceutike

-33600000-6

Fondi limit* vlera e pritshme e kontratave ne marrëveshjen kuadër: 1,106,075.7 (nje million e njeqind e gjashte mije e
shtatedhjetë e pese pike shtate) Lekë pa TVSH.

Loti	Sistemi	Principi aktiv	Formedoza	Njesia	Sasia	Fondi limit pa tvsh	Fondi limit me germa leke(pa TVSH)
Loti 1	Sistemi kardiovaskular	Amiodarone	150 mg/3 ml - 3 ml	Ampule	730	42,636.0	dyzete e dy mije e gjashteqind e tridhjetë gjashtë
Loti 2	Sistemi kardiovaskular	Nifedipine	10 mg	Tablete	2,800	19,656.0	nentembehjetë mije e gjashteqind e pesedhjetë e gjashtë
Loti 3	Sistemi kardiovaskular	Amiodarone	200 mg	Tablete	2,400	15,941.4	pesembehjetë mije e nente qind e dyzete e nje pike kater

Loti 4	Sistemi nervor	Chlorpromazine	50 mg/2 ml - 2 ml	Ampule	200	10,800.0	dhjete mije e teteqind
Loti 5	Sistemi nervor	Phenobarbital	200 mg/2ml - 2 ml	Ampule	1,300	68,796.0	gjashtedhjete e tete mije e shtateqind e nentedhjete e gjashte
Loti 6	Sistemi nervor	Naloxone	0.4 mg/ml	Flakon	20	1,694.3	nje mije e gjashteqind e nentedhejte e kater pike tre
Loti 7	Barna Antineoplastike dhe immunomodulatore	Paclitaxel	100 mg/16.7 ml	Flakon	400	361,332.0	treqind e gjashtedhjete e nje mije e treqind e tridhjete e dy
Loti 8	Barna Antineoplastike dhe immunomodulatore	Gemcitabine	1 gr	Flakon	80	359,520.0	treqind e pesedhjete e nente mije e peseqind e njezete
Loti 9	Barna Antineoplastike dhe immunomodulatore	Gemcitabine	200 mg	Flakon	100	102,000.0	njeqind e dy mije
Loti 10	Barna Antineoplastike dhe immunomodulatore	Cyclophosphamide anhydrous	500 mg	Flakon	100	74,700.0	shtatedhjete e kater mije e shtateqind
Loti 11	Anti tuberkulare	PPD Tuberculin	5TU/0.1-2ml (15 doses)	Flakon	10	49,000.0	dyzete e nente mije

Argumentim: Bazuar në shkresën e MSHMS me Nr. 3584/17 datë 14.11.2024 protokolluar këtu me nr.5966 prot., datë 15.11.2025 ku delegohet blerje e disa barnave dhe shkresës 2324 prot., date 17.05.2025 të MSHMS protokolluar këtu me Nr. 2348 prot., datë 23.05.2024 ku l delegohet Qsr Berat Blerja e disa medikamenteve dhe shkreses se MSHMS me Nr.2521/1 Prot., datë 01.07.2025 protokolluar këtu me Nr. 3067/1 Prot., datë 03.07.2025, bazuar në kërkesën e miratuar të "Shërbimit të Farmacisë" me Nr. 3768 Prot., datë 11.07.2025, dhe kërkesen Nr.4193 Prot., datë 31.07.2025 informacion nr. 4246 date 05.08.2025, bazuar në Proçes Verbalin me Nr. 4217 Prot., datë 04.08.2025 dhe procesverbalin Nr. 4222 Prot., datë 04.08.2025 mbi fondin limit të proçedurës, për realizimin e proçedurës së prokurimit me objekt: **"Blerje barnash te deleguara për nevoja Spitalore ndarë në 11 lote"** shkresës Cleje zeri l ri në regjistrin e parashikimeve të Prokurimeve Publike me Nr.4247 date 05.08.2025 ,nenet 34,35 te ligjit Nr. 162/2020 dhe nenin 76 pika c e VKM_RPP_285_19.05.2021 për proceduren e hapur te thjeshtuar me objekt: **"Blerje barnash te deleguara për nevoja Spitalore ndarë në 11 lote- Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për sejcilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj"** me fond limit/vlera e pritshme e kontratave në total prej 1,106,075.7 (nje million e njeqind e gjashte mije e shtatedhjete e pese pike shtate) Lekë pa TVSH.

Lloj I procedures> Procedure e Hapur e Thjeshtuar Mallra -Në mbështetje të Nenit 33-Kufijtë monetarë pika 1- b) kufiri i ulët monetary, Neni 41-Procedurat standarde të prokurimit pika 1- ë) procedurë e hapur e thjeshtuar, Neni 49 - Procedurë e hapur e thjeshtuar të ligjit Nr. 162/2020 datë 23/12/2020 te ndryshuar “Për Prokurimin Publik”, Neni 49-Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote, Neni 11-Kufijtë monetarë, Neni 46 -Llojet e procedurave të prokurimit pika 2- f-procedurë e hapur e thjeshtuar , Neni 55-Procedura e hapur e thjeshtuar, Neni 115-Udhëzime dhe manualët shpjeguese në VKM_RPP_ 285_19.05.2021 për “ Rregullat e Prokurimit Publik” i ndryshuar, Vendimin Nr. 291 date 15.05.2024 Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik.

Argumentimi: Në bazë të nenit 21 “Autoriteti ose enti kontraktor”, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 I ndryshuar“Për prokurimin publik”, nenit 2 “Dokumentimi i procesit”, pika 2/c dhe nenit 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar,autoriteti/enti kontraktor Qendra Spitalore Rajonale Berat ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

_____ Te njejta për Lotet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11,

Shtojca 8.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pushlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërket për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërket për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfatësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Argumentimi: Kërkesat e përgjithshme të kualifikimit dhe kërkesat e pikës 1 (gërmat a / b) të kriterëve të veçanta të kualifikimit janë parashikuar pa ndryshime, sipas formatit të dokumenteve standarde të tenderit të publikuara nga APP, dhe vendosja e tyre është bazuar në nenet 76 “**Kriteret detyruese për skualifikim**”, 82 “**Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit**” dhe 83 “**Sigurimi i ofertës**” të Ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” ndryshuar, nenit 26 “**Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit**”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” I ndryshuar.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar në të cilën është e përcaktuar se: "1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Nuk Aplikohet pasi vlera është poshtë vlerës të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Argumentim: Ky kriter u vendos sipas nenit 83/1 të Ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, në të cilën është e parashikuar se: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Si dhe Nenit 83/2 ku përcaktohet se: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2022, 2023, 2024**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 20% e fondit limit/vlera e pritshme e kontratave të lotit apo shumës së loteve për të cilat oferton sipas tabelës së mëposhtme. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Shënim*: Për efekt të përllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 20% do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme për të cilën ofertohej, konkretisht mbi vlerat e kolonës "Vlera e pritshme e kontratave" në piken 2.10.

Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore, në përputhje me parashikimet e nenit 40, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021.

Argumentimi: Ky kriter, është vendosur në përputhje me piken 3 të nenit 77 të Ligjit nr 162/2020, "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare,

autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.; ne piken 1 dhe piken 2/a të nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: Pika 1.Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar.

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim të bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet dokumenteve të kërkuara me poshte, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Legjislatori në nenin 55/4 të VKM 285/2021 ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur të Thjeshtuar, e cila është 40 % e Fondit Limit të kontratës së shpallur.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 'Mbi Rregullat e Prokurimit Publik' ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, **për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;**si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 'Për Tatimin Mbi të Ardhurat' i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore të ardhurave.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të lotit apo shumatores së fondit limit të loteve për të cilat oferton,

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe ***sasite e mallrave të realizuara.***

ose

B) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe ***sasite e mallrave të realizuara.***

Shënim:Për efekt të përllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 20% do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme për të cilën ofertohej, konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” në piken 2.10.*

Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore, në përputhje me parashikimet e nenit 40, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021.

Argumentimi:Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”,ne të cilin gjejmë të përcaktuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe referuar nenit 55 pika 4 gërma b e VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” është përcaktuar që furnizimet e mallrave të mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nepermjet përvajave të duhura, që janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe referuar nenit 55 pika 4 gërma b e VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” është përcaktuar që furnizimet e mallrave të mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK dhe nenit 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për tregëtim me shumicë të barnave të lëshuar nga QKL ose QKB.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me piken 1 të nenit 77 të Ligjit nr.162/2020”Per Prokurimin Publik”, në të cilin gjejmë të përcaktuar se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe në piken 1 të nenit 28 të Ligjit nr. 105/2014 “Për barnat dhe Sherbimin Farmaceutik” në të cilën është e përcaktuar se: Tregtimi me shumicë i barnave kryhet nga importuesi, eksportuesi, shpërndarësi farmaceutik, që është person juridik ose fizik, tregtar, vendas ose i huaj, i pajisur me licencën përkatëse për këtë veprimtari, sipas legjislacionit përkatës për licencimin”. 2. Tregtuesi farmaceutik me shumicë mund të tregtojë me shumicë edhe pajisjet mjekësore, sipas përcaktimeve të bëra në legjislacionin përkatës për pajisjet mjekësore” si dhe Ligjin nr 10081 datë 23.02.2009 (i ndryshuar) “Për licensat, autorizimet dhe lejet në RSH”. (shënim - përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse të furnizimit, ose nëse është rasti të prodhimit të mallrave objekt prokurimi, që lidhet me objektin e kontratës së prokuruar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë mbi origjinën e mallit (vendi i prodhimit dhe kompaninë prodhuese / MAH) përbarin e ofertuar.

Argumentimi: Argumentimi: Kriteri i vendosur është në përputhje me nenin 38, nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik. Deklarata mbi origjinën e mallit (kompaninë prodhuese dhe vendi prodhimit) është kërkuar në mënyrë që me anë të saj do të bëhet krahasimi i ofertes, barnave që ofertohej nga OE me autorizimin e prodhuesit dhe dokumentacionin teknik që do të paraqitet në SPE.

Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese/MAH, kjo të plotësohet në Shtojcën 2. Listat e Çmimeve të artikujve të DST. Argumentimi: Ky kriter vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese/mbajtësin e autorizimit për tregëtim për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimin të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion në përputhje me nenin 40, pika 6 dhe 8, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.3.4 Për barnat (e listës së DST) të autorizuar për tregtim në Republikën e Shqipërisë, duhet të paraqitet:

- dokumenti i cili konfirmon se bari i ofertuar, është i pajisur me autorizim për tregtim në Republikën e Shqipërisë, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore
- /ose/
- autorizimi për tregtim i barit, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, brenda afatit të tij të vlefshmërisë.

Argumentimi: Ky kriter gjen mbështetje në piken 2 dhe 4, të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, si dhe Ky kriter vendoset në përputhje në piken 3 të nenit 3, në piken 1 të nenit 1, me Nenin 11 të Ligjit Nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, i ndryshuar, ku në pikën 1 të këtij neni citohet: “1. Barnat që vendosen në treg në Republikën e Shqipërisë për përdorim njerëzor duhet të jenë të pajisura me autorizim për tregtim nga Agjencia

2.3.5 Për barnat (e listës së DST) të paautorizuara për tregtim në Republikën e Shqipërisë, bari që ofertohej duhet:

- a. të ketë marrë autorizim për tregtim dhe të qarkullojë në njërën nga vendet e Bashkimit Evropian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanada, Turqi, Zvicër, Izrael, Japoni, Australi, Norvegji, Islandë dhe Mbretëri e Bashkuar;

/ose/

- b. të jetë i prodhuar në vendet e Ballkanit, vetëm nëse ka marrë autorizim për tregtim dhe qarkullon në vendin e tij,

/ose/

- c. të jetë i pajisur me autorizim për tregtim nga Agjencia Evropiane e Barnave (EMA), ose Institucioni i Administrimit për Ushqimin dhe Barnat (FDA) i Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Për këtë kërkohet që ofertuesi të paraqesë:

- Deklaratë me anën e të cilës të konfirmohet se bari që ofron, është i pajisur me autorizim për tregtim dhe qarkullon në një nga vendet e mësipërme (të Bashkimit Evropian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanada, Turqi, Zvicër, Izrael, Japoni, Australi, Norvegji, Islandë dhe Mbretëri e Bashkuar), ose që disponon autorizim për tregtim nga FDA ose EMA.

Në deklaratën e nëshkruar dhe të vulosur nga ofertuesi duhet të deklarohen: Emri dhe adresa e plotë e Institucionit/eve të autorizuar që kanë lëshuar autorizimin për tregtim; Të dhëna kontakti për këto institucione (Tel, fax, e-mail, ëeb-site); Numri dhe data e lëshimit të autorizimit për tregtim (nga Institucioni/et të autorizuar) të barit që ofron dhe periudhën e vlefshmërisë të këtij autorizimi.

Argumentimi: Ky kriter u vendos ne mbështetje të pikës 2 dhe 4, te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik", si dhe ne nenin 12 dhe ne nenin 14 te Ligjit nr.105/2014 "Per Barnat dhe Sherbimin Farmaceutik". Kerkimi i dokumentit qe parashikohet ne piken c) te kapacitetit teknik eshte ne perputhje me ligjin perkates per barnat.Ky kriter vendoset në zbatim të Nenit 11, pika 2, të Ligjit Nr. 105/2014 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", të ndryshuar, e cila, parashikon: "2. Në raste nevojash të shërbimit shëndetësor (për mjekim ambulator dhe/ose spitalor), për barna të cilat nuk kanë asnjë alternativë të ngjashme, e cila ka autorizim për tregtim nga Agjencia, ministri përgjegjës për shëndetësinë autorizon importimin e barnave, për të cilat nuk është lëshuar autorizim tregtimi nga Agjencia, sipas rregullave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave". 10 Gjithashtu, me qëllim garantimin e përmbushjes së standardeve mbi sigurinë, cilësinë dhe efikasitetin e barnave, edhe në rastin e barnave të paautorizuara, janë aplikuar të njëjtat kërkesa mbi origjinën e tyre, sikurse për barnat e autorizuara për tregtim. Kjo, duke u bazuar në Nenin 12, pika 2, të Ligjit Nr. 105/2014 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", të ndryshuar, e cila parashikon: "2. Agjencia i propozon ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhënien e autorizimit të tregtimit për: a) barnat e prodhuara në vendin tonë; b) barnat që kanë marrë autorizim për tregtim dhe që qarkullojnë në njërin nga vendet e Bashkimit Europian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanada, Turqi, Zvicër, Izrael, Japoni, Australi, Norvegji, Islandë dhe Mbretëri e Bashkuar; b/1) barnat që kanë marrë autorizim për tregtim lokal dhe që qarkullojnë në vend, duke përmbushur përcaktimet e shkronjës "b" të pikës 2 të këtij neni.". c) barnat e prodhuara në vendet e Ballkanit, vetëm kur kanë marrë autorizim për tregtim dhe qarkullojnë në vendin e tyre; ç) barnat e pajisura me autorizimin e tregtimit nga Agjencia Evropiane e Barnave (EMA) ose Institucioni i Administrimit për Ushqimin dhe Barnat (FDA) i Shteteve të Bashkuara të Amerikës." Në bazë të të dhënave të deklaruara , KVO është në gjendje të bëjë verifikimin e tyre.

2.3.6 Për barnat e parashikuara të DST, kërkohet Autorizim (i vlefshëm për periudhën 2025 - 2026), lëshuar nga MAH (mbajtësi i autorizimit të tregtimit), nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë barnat e tij në vendin tonë.

2.3.7 Për barnat e parashikuar të DST, kërkohet Autorizim (i vlefshëm për periudhën 2025 - 2026), lëshuar nga MAH (mbajtësi i autorizimit të tregtimit) ose prodhuesi, ose distributori i autorizuar, nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë barnat e tyre në vendin tonë.

Shënim: Në rastin e autorizimeve të lëshuara nga distributorët e autorizuar, duhet të provohet me dokumente lidhja e tyre (distributorëve të autorizuar) me prodhuesin/MAH (mbajtësin e autorizimit të tregtimit).

Argumentimi: Kriteri 2.3.6 dhe 2.3.7 gjen mbështetje në nenin 11 dhe në nenin 12 të Ligjit nr. 105/2014 “*Per Barnat dhe Sherbimin Farmaceutik*” i ndryshuar. Gjithashtu vendosja e këtij kriteri gjen mbështetje edhe tek pika 4 vendosen në përputhje me nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar (aftësia teknike), si dhe pika 3 e nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, me qëllim zotërimin e reputacionit dhe besueshmërisë për zbatimin e kontratës. Afati i vlefshmërisë së autorizimit vendoset në përputhje me kohëzgjatjen e MK. Keto kërkesa dhe vecanerisht lidhja me distributorin për barnat e pa autorizuar për tregtim në RSH, i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës pra të garancojë se furnizimi të mallit objekt prokurimi si dhe në rekomandimin e APP nr. 3341/1 prot, datë 20.03.2018 “*Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në dokumentat e tenderit të procedurave të prokurimit publik*”. Për sa me sipër cituam, cmojmë se kerkimi i dokumentit që parashikohet është në përputhje me ligjin përkatës për barnat.

Shënim për operatorët ekonomik:

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike*¹. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve ankimit, do t’i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit përmbushës për keto pika do të jete kusht skualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor mund të bejë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht skualifikimi.
- Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Objekti i kontratës/marrveshjes kuadër: “Blerje barnash te deleguara për nevoja Spitalore ndarë në 11 (njembedhjetë) lote- *Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj*”.

Fondi limit* vlera e pritshme e kontratave ne marrëveshjen kuadër: 1,106,075.7 (nje million e njeqind e gjashte mije e shtatedhjetë e pese pike shtate) Lekë pa TVSH.

Loti	Sistemi	Principi aktiv	Formedoza	Njesia	Sasia
Loti 1	Sistemi kardiovaskular	Amiodarone	150 mg/3 ml - 3 ml	Ampule	730
Loti 2	Sistemi kardiovaskular	Nifedipine	10 mg	Tablete	2,800
Loti 3	Sistemi kardiovaskular	Amiodarone	200 mg	Tablete	2,400
Loti 4	Sistemi nervor	Chlorpromazine	50 mg/2 ml - 2 ml	Ampule	200
Loti 5	Sistemi nervor	Phenobarbital	200 mg/2ml - 2 ml	Ampule	1,300
Loti 6	Sistemi nervor	Naloxone	0.4 mg/ml	Flakon	20
Loti 7	Barna Antineoplastike dhe immunomodulatore	Paclitaxel	100 mg/16.7 ml	Flakon	400
Loti 8	Barna Antineoplastike dhe immunomodulatore	Gemcitabine	1 gr	Flakon	80
Loti 9	Barna Antineoplastike dhe immunomodulatore	Gemcitabine	200 mg	Flakon	100
Loti 10	Barna Antineoplastike dhe immunomodulatore	Cyclophosphamide anhydrous	500 mg	Flakon	100
Loti 11	Anti tuberkulare	PPD Tuberculin	5TU/0.1-2ml (15 doses)	Flakon	10

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Afati I skadencës: Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më pak se 1/2 e kohës ndërmjet dates së prodhimit dhe asaj të skadencës /ose/ jo më pak se 1 vit nga data e lëvrimit të mallit.

- Formë – doza, njësia dhe volume për secilin bar është përcaktuar në DST dhe është detyruese të jetë sipas specifikimeve teknike.
- Paketimi: Mbi çdo paketim duhet të jetë shënuar emir I barit, formë - doza, kodi I barit, përqindja dhe përmbajtja, data e prodhimit dhe e skadencës, nr. I serisë, si edhe përveç pullës së kontrollit të barnave të aplikuar në paketimin e jashtëm/kutinë e ambalazhit të tyre, barnat duhet detyrimisht të jenë të vulosura edhe me vulën me mbishkrimin “PËRDORIM SPITALOR - NDALOHET SHITJA”.

Ofertuesi duhet të përmbushë specifikimet teknike sipas përcaktimit të bërë në përshkrimin e mallrave në DST të kësaj procedurë prokurimi.

Argumentim: Sipas kërkesës së përcaktuar në Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë Nr 287, datë 12.07.2011, Nr Prot 2542, datë 12.07.2011 “Për pajisjen me vulë të barnave që përdoren në institucionet shëndetësore publike”.

Specifikimet teknike janë vendosur në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP: “38/b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë” si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, “për mallrat që do të prokurohen, autoriteti/enti kontraktor parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementëve më të rëndësishëm përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.”

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë

ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Loti	Sistemi	Principi aktiv	Formedoza	Njesia	Sasia
Loti 1	Sistemi kardiovaskular	Amiodarone	150 mg/3 ml - 3 ml	Ampule	730
Loti 2	Sistemi kardiovaskular	Nifedipine	10 mg	Tablete	2,800
Loti 3	Sistemi kardiovaskular	Amiodarone	200 mg	Tablete	2,400
Loti 4	Sistemi nervor	Chlorpromazine	50 mg/2 ml - 2 ml	Ampule	200
Loti 5	Sistemi nervor	Phenobarbital	200 mg/2ml - 2 ml	Ampule	1,300
Loti 6	Sistemi nervor	Naloxone	0.4 mg/ml	Flakon	20
Loti 7	Barna Antineoplastike dhe immunomodulatore	Paclitaxel	100 mg/16.7 ml	Flakon	400
Loti 8	Barna Antineoplastike dhe immunomodulatore	Gemcitabine	1 gr	Flakon	80
Loti 9	Barna Antineoplastike dhe immunomodulatore	Gemcitabine	200 mg	Flakon	100

Loti 10	Barna Antineoplastike dhe immunomodulatore	Cyclophosphamide anhydrous	500 mg	Flakon	100
Loti 11	Anti tuberkulare	PPD Tuberculin	5TU/0.1-2ml (15 doses)	Flakon	10

Afatet e lëvrimit: Per te gjitha Lotet:

Kontratat do te jepen brenda periudhës: Nga momenti i lidhjes se Marrëveshjes Kuader me OE te shpallur fitues për secilin lot, me afat perfundimtar 12 muaj nga data e nënshkrimit të MK-se.

Qendra Spitalore Rajonale Berat do të lidhë kontratë në bazë të nevojave të saj në çdo 4 mujor. Përjashtimisht këtij përcaktimi, autoriteti kontraktor mund të lidhin kontratë për çdo nevojë që del e paparashikuar dhe është e domosdoshme në çdo kohë.

- Për çdo kontrate të lidhur brenda marrëveshjes kuadër, sipas përcaktimit më sipër, afatet e lëvrimit do te jene sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Vendi i dorezimit te mallit do të bëhet prane Farmacise se Qendres Spitalore Rajonale Berat.

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit

Ofertuesi duhet të përmbushë specifikimet teknike sipas përcaktimit të bërë në përshkrimin e mallrave në DST të kësaj procedurë prokurimi.

Argumentimi per sasite dhe specifikimet teknike jane vendosur ne baze te materialit te pergatitjes sasive dhe te specifikimeve teknike ne Kërkesen e SHerbimit te Farmacise te miratuar nga Drejtoria e QSRB për “Blerje barna te deleguara ” me Nr.198 Prot., datë 13.01.2025 dhe shkreses se përlogaritjes të fondit limit me Nr.1047 Prot., datë 18.02.2025si dhe ne perputhje me nenin 4, pika 38/b te Ligjin nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, nenin 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe neneve 20 dhe 49 teLigjit nr. 105/2014 “Per Barnat dhe Sherbimin Farmaceutik”

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për Mallin objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdokërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Të respektohen specifikimet teknike të kërkuara nga shërbimet për çdo artikull.

NJESIA E PROKURIMIT

Armelin Çili

Elona Dundo

Anesti Kushi

MIRATOI

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Arben KONOMI